



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me gra, buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistët dhe OJQ

Me datë: 24.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/8-Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionist-dhe-OJQ.pdf>

Me 24.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionist-dhe-ojq/>

Me 13.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për gra buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistet dhe-OJQ:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionistet-dhe-OJQ.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 18:10

Dëgjimi buxhetor me gra, buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistet dhe OJQ i mbajtur me datë 08.08.2024.

Hapjen e dëgjimit është bërë nga Ymer Berisha, Udhëheqësi i Njesisë për Komunikim me Publikun i cili ka thënë se kemi jemi në këtë dëgjim buxhetorë që t'ju dëgjojmë kërkesat që ju i keni, sigurishtë që zyrtarët përgjegjës do të majnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe raport të detjashëm për mbajtjen e këtij dëgjimi. Fjalën fillimisht do të marrë kryetari, pastaj drejtori i financave do të bëjë prezantimin e buxhetit dhe më pas ju qytetarë të nderuar do të keni mundësinë që ti bënë kërkesat tuaja.

Shaqir Totaj, kryetar i komunës, ka thënë në këtë dëgjim ne do ti marrim kërkesat që ju i keni dhe më pas ato kërkesa do të futën në buxhetin e vitit 2025 dhe gjithashtu në buxhetin e viteve 2026 dhe 2027, pasi që disa kërkesa do të realizohen në vitin 2025 e disa në vitet në vazhdim. Mundësitë buxhetore janë këto që janë dhe nuk ka mundësi që të realizohen të gjitha kërkesat pasi që buxheti nuk mjafton.

Sultan Badalli, drejtor për Buxhet dhe financa, buxheti i komunës është dokumenti më i rëndësishëm i një organizate buxheteore, projekt buxhetin e komunës e kemi përgatitur duke u bazuar në qarkoren e parë të ministrisë së financave. Buxheti është i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve:

Daut Qylangjiu, janë bërë punë të mira, por që ne sigurisht që kemi edhe kërkesa tjera e që mendojmë që janë të rëndësishëm për gjithë banorët, kërkesat e mia janë:
Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Nusret Searsoj,
Ndërtimin e një qendre kulturore për Romet.

Resmije Krasniqi, duke ju falënderuar për angazhimin tuaj, kisha kërkuar që të ketë buxhet më shumë nëpër drejtori dhe kërkesat e mia janë këto:

Dyfishimi i buxhetit për Drejtorin për Mirëqenia Sociale
Krijimin e një hapësirë (local) për promovimin e punimeve të shoqatës Hader.

Shyret Hoxha, e kërkesat e mia që besoj që do të hynë në buxhetin e vitit 2025 janë këto:

Ndriçimi dhe rregullimi i rrugës Edit Durham,
Ndriçimi publik në lagjen Jeta e re,
Kubzimi i rrugëve Justiniani dhe At Mejdan,
Rregullimi i rrugës Janina.

Linda Simitçiu, si OJQ jemi falënderuar për punën e bërë por që mirë është që të planifikohet investim edhe në këtë dy objekte e që mendojmë që janë të një rëndësisë të veçantë:

Rregullimi i qendrës rinore në Ortakoll,
Rregullimi i bunkerit në lagjen Ortakoll.

Osman Osmani OJQ-Nevo Koncepti, duke ju falënderuar për gjithë angazhimin tuaj që po bëni për komunitetin tonë, kisha kërkuar që ti realizoni edhe këto kërkesa pasi që janë të rëndësishme për komunitetin Romë:

Hapja e çerdheve dhe klasave në edukim të hershëm,
Punësimi i një përkthyesi për gjuhën romë.

Dëgjimi ka përfunduar në orën 18:50

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund të gjeni në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund të gjeni në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi